

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 11

Kontaratat e Ndërtimit

Objektivi

Objektivi i këtij Standardi është që të trajtojë të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me kontratat e ndërtimit. Për shkak të natyrës së aktivitetit në një kontratë ndërtimi, data në të cilën kontrata ka filluar dhe data në të cilën përfundon ndërtimi përgjithësisht i përkasin periudhave të ndyshme kontabel. Prandaj, dhe çështja kryesore në trajtimin kontabel të një kontrate ndërtimi është përcaktimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën përkatëse kontabel në të cilën është kryer puna. Ky Standard përdor të njëjtin kriter njohjeje të vendosur në *Kuadrin Konceptual të Përgatitjes dhe Prezantimit të Pasqyrave Financiare* për të përcaktuar se kur të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me kontratën duhet të njihen si të ardhura dhe shpenzime në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të periudhës. Ai gjithashtu jep dhe udhëzimin praktik të aplikimit të këtyre kritereve.

Objekti

- 1 Ky Standard duhet të aplikohet në kontabilizimin e kontratave të ndërtimit në pasqyrat financiare të ndërtuesit të kontraktuar.
- 2 Ky Standard zvendeson SNK 11 *Kontabiliteti i Kontratave të Ndërtimit* miratuar në 1978.

Përkufizime

- 3 **Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore që përdoren në këtë standard:**

Një kontratë ndërtimi është një kontratë specifikuar e negociuar për ndërtimin e një aktivi ose një kombinim aktivesh që janë të lidhur ngushtë apo të ndërvarur në kuptimin e projektit, teknologjisë dhe funksionimit apo përdorimit final të tyre.

Një kontratë me çmim të fiksuar është një kontratë ndërtimi në të cilën kontraktori bie dakord për një kontratë me çmim të fiksuar, ose një çmim të fiksuar për njësi prodhimi, i cili në disa raste është i kushtëzuar me përshkallëzimin në rritje të kostos.

Një Kontratë me çmim të ndryshueshem është një kontratë ku ndërtuesi rimbursohet për kosto të lejueshme ose specifikuar të përcaktuara, plus një përqindje mbi këto kosto ose një tarifë fikse.
- 4 Një kontratë ndërtimi mund të negociohet për ndërtimin e një aktivi të vetëm si psh një urë, ndërtesë, mur rrethues, sistem tubacionesh, rrugë, anije apo tunel. Një kontratë ndërtimi mund të ketë si objekt gjithashtu dhe ndërtimin e një numri aktivesh të cilët janë të lidhur ngushtë apo të ndërvarur nga njëri-tjetri në kuptimin e projektit, teknologjisë dhe funksionit apo të përdorimit final të tyre. Shëmbuj të kontratave të tilla mund të përmëndim ato të ndërtimit të rafinerive apo të pjesëve komplekse të fabrikave apo të makinerive.
- 5 Për qëllim të këtij Standardi, kontratat e ndërtimit përfshijnë:
 - (a) Kontrata e shërbimeve të cilat janë të lidhura në mënyrë direkte me ndërtimin e një aktivi, për shëmbull, kontratat e shërbimit të drejtuesve të projektit dhe të arkitektëve. dhe
 - (b) Kontrata për prishjen dhe restaurimin e aktivitetit, dhe restaurimin e ambientit mbas shkatërrimit të aktivitetit.
- 6 Kontratat e ndërtimit janë të formuluar në mënyra të shumta dhe të larmishme të cilat për qëllim të këtij Standardi, janë klasifikuar si kontrata me çmim fikse dhe kontrata me çmim të ndryshueshem. Disa kontrata ndërtimi mund të përmbajnë karakteristika të të dyjave, të kontratës me çmim fikse dhe të asaj me çmim të ndryshueshem, për shëmbull një kontratë me çmim të ndryshueshem por me një çmim maksimal të pranuar. Në të tilla rrethana, një ndërtuesi i nevojitet të marrë në konsideratë të gjitha

kushtet në pragrafët 23 dhe 24 me qëllim që të përcaktojnë se kur duhet të njohë të ardhurat dhe shpenzimet e kontratës.

Kombinimi dhe segmentimi i kontratave të ndërtimit

- 7 Kërkesat e këtij Standardi normalisht aplikohen veçmas për çdo kontratë ndërtimi. Gjithësesi, në situata të caktuara, është e domosdoshme që Standardi të aplikohet veçmas për komponentë të veçantë të një kontrate të vetme apo grup kontratash së bashku me qëllim që të reflektohet permbajta e kontratës apo grup kontratave.
- 8 **Kur një kontratë përmbledh një numur aktivesh, ndërtimi i çdo aktivi duhet të konsiderohet si një kontratë e veçantë kur:**
- (a) për çdo aktiv janë mbledhur oferta të veçanta;
 - (b) çdo aktiv ka qënë subjekt më vete i negocimit dhe, ndërtuesi dhe klienti kanë patur mundësi të pranojnë apo refuzojnë atë pjesë të kontratës që lidhet me sejcilin aktiv; dhe
 - (c) kostot dhe të ardhurat e çdo aktivi mund të jenë të identifikueshme.
- 9 **Një grup kontratash, me një apo më shumë klientë, duhet të trajtohen si një kontratë e vetme ndërtimi kur:**
- (a) grupi i kontratave është negociuar si një paketë e vetme;
 - (b) kontratat janë të ndërlidhura aq ngushtë me njëra-tjetrën sa që, ato në fakt janë pjesë e një projekti të tërë me objektiv fitimi të përbashkët; dhe
 - (c) kontratat zbatohen në mënyrë të njëkohshme ose njëra pas tjetrës.
- 10 **Një kontratë mund të ofrojë ndërtimin e një aktivi shtesë si një opsion për klientin ose mund të rishikohet (amendohet) me qëllim që të përfshijë dhe ndërtimin e aktivit shtesë. Ndërtimi i aktivit shtesë duhet të trajtohet si një kontratë më vete kur:**
- (a) Aktivi është i dryshëm në projekt, teknologji apo funksionim, nga aktivi që i përkiste kontratës së mëparshme; ose
 - (b) çmimi i aktivit është negociuar pa marrë parasysh kontratën e mëparshme.

Të Ardhurat Nga Kontrata

- 11 **Të ardhurat nga kontrata përmbajne:**
- (a) shumën fillestare të të ardhurave të rëna dakord në kontratë; dhe
 - (b) variacionet në kontratë, pagesat për çështjet e negociuara si dhe pagesat për nxitje-motivim;
 - (i) për aq sa mund të jetë e mundur që këto pagesa do rezultojnë në të ardhura dhe
 - (ii) ata janë të aftë të bëjnë një matje të besueshme të vlerës.
- 12 Të ardhurat e kontratës maten me vlerën e drejte të pagesave të marra ose për tu marrë. Matja e të ardhurave të kontratës ndikohet nga një sërë pasigurish që varen nga rezultati i ngjarjeve të mëvonshme. Parashikimet shpesh duhen riparë pasi ngjarje të reja ndodhin dhe pasiguritë kanë një zgjidhje. Kështu që, shuma e të ardhurave të kontratës mund të rritet ose zvogëlohet nga një periudhë në tjetrën. Për shëmbull:
- (a) një ndërtues dhe një klient mund të bien dakort për variacionet ose ankesat që rrisin apo zvogëlojnë vlerën e kontratës në periudhën pasardhëse pas asaj të nënshkrimit të kontratës;
 - (b) shuma e të ardhurave të një kontratë me çmim fiks mund të rritet si rezultat i kushtit të përshkallëzimit në rritje të kostos;
 - (c) shuma e të ardhurave të kontratës mund të ulet si rrjedhojë e penaliteteve për shkak të vonesave nga ana e ndërtuesit në përfundimin e kontratës; ose

- (d) kur një kontratë me çmim fiks i referohet një çmimi fiks për njësi prodhimi, të ardhurat e kontratës rriten si pasojë e rritjes së njësisive të prodhuara.
- 13 Një variacion (ndryshim) është një instruksion nga ana e klientit për të bërë një ndryshim në objektin e punës që kontrata mbulon. Një variacion mund të çojë në rritjen apo zvogëlimin e të ardhurave të kontratës. Shëmbuj të variacioneve të kontratave janë ndryshimet në specifikimet ose projektimet e aktiveve dhe ndryshime në afatet e kontratës. Një variacion përfshihet në të ardhurat e kontratës kur:
- (a) ka shance pozitive që klienti do të aprovojë ndryshimin dhe shumën e të ardhurave që vijnë prej tij; dhe
- (b) shuma e të ardhurave matet me besueshmëri.
- 14 Një ankesë është një shumë që ndërtuesi pretendon ta marrë nga klienti ose nga një palë tjetër si një rimbursim për shpenzime që nuk janë përfshirë në çmimin e kontratës. Një ankesë mund të vijë për shëmbull si pasojë vonesave të shkaktuara nga klienti, gabime në projektime apo specifikime, dhe mosmarrveshje në ndryshimet e kontratës. Përcaktimi i shumës së të ardhurave që vijnë si rezultat i ankesave shoqërohet me një nivel të lartë pasigurie dhe shpesh varet nga rezultati i negociatave. Prandaj, ankesat përfshihen në të ardhurat e kontratës vetëm kur:
- (a) negociatat kanë arritur një stad të avancuar saqë, ka gjasa se klienti do të pranojë ankesën; dhe
- (b) shuma që klienti ka mundësi të pranojë mund të matet në mënyrë të besueshme.
- 15 Pagesat nxitëse janë pagesa shtesë që i jepen ndërtuesit në rast se ai ka plotësuar apo tejkaluar disa standarde të vendosura më parë. Për shëmbull, një kontratë mund të parashikojë një pagesë nxitëse (shtesë) për ndërtuesin në rast të përfundimit të kontratës para afatit të caktuar. Pagesat nxitëse përfshihen në të ardhurat e kontratës kur:
- (a) kontrata ka avancuar në mënyrë të tillë saqë është plotësisht e mundëshme të besohet se standardet e vendosura do të plotësohen ose tejkalohen. dhe
- (b) shuma e pagesave nxitëse mund të matet në mënyrë të besueshme.

Kosto e kontratës

- 16 **Kosto e kontratës përmban:**
- (a) **kostot që lidhen direkt me kontratën në fjalë;**
- (b) **kosto që i atribuohen aktivitetit të kontratës në përgjithësi dhe mund t'i bashkohen kontratës; dhe**
- (c) **kosto të tjera të cilat specifikisht në bazë të kontratës i ngarkohen klientit.**
- 17 Kosto që lidhen direkt me një kontratë përfshijnë:
- (a) kostot e punës të lidhura me kantjerin, duke përfshirë dhe mbikqyrjen e punimeve;
- (b) kosto e materialeve të përdorura në ndërtim;
- (c) amortizimi i paisjeve dhe makinerive të përdorura gjatë kontratës;
- (d) kosto e lëvizjes së paisjeve, makinerive dhe materialeve për në kantjer dhe nga kantjeri;
- (e) kosto e marrjes me qera të paisjeve dhe makinerive;
- (f) kosto e projektimit dhe asistencës teknike që lidhet direkt me kontratën;
- (g) kosto e parashikuar e ristrukturimit dhe punëve të garancisë, duke përfshirë dhe koston e garancisë; dhe
- (h) kostot e ankesave nga palët e treta.
- Këto kosto mund të zvogëlohen nga ndonje e ardhur e rastesishme që nuk është përfshirë në të ardhurat e kontratës, për shëmbull të ardhurat nga shitja e materialeve të tepërta dhe nga shitja e makinerive dhe paisjeve në fund të kontratës.
- (18) Kostot që mund të shkattohen nga aktiviteti kontraktor në përgjithësi dhe që shpërndahen në kontrata specifike përfshijnë;

- (a) siguracionin
- (b) kosto e projektimit dhe asistencës teknike që nuk lidhen direkt me një kontratë specifike; dhe
- (c) shpenzime me karakter të përgjithshëm të kontratës.

Kosto të tilla shpërndahen duke përdorur metoda që janë sistematike, racionale dhe që aplikohen vazhdimisht tek të gjitha kostot e tjera me karakteristika të njëjta. Shpërndarja bazohet në nivelin normal të aktivitetit të kontratës. Shpenzimet e përgjithshme të ndertimit përfshijnë kosto të tilla si përgatitja dhe procesimi i listpagesës së personelit të ndertimit. Kostot që mund të shkarkohen nga aktiviteti kontraktor në përgjithësi dhe që mund të shpërndahen në kontrata specifike, përfshijnë gjithashtu kostot e huamarrjes kur kontraktori zbaton alternativën e lejuar në SNK 23 *Kostot e huamarrjes*.

- 19 Kostot që janë specifikisht për t'iu ngarkuar klientit sipas kushteve të kontratës mund të përfshijnë disa shpenzime të përgjithshme administrative dhe shpenzime të zgjerimit, rimbursimi i të cilave është specifikisht i përcaktuar në kontratë.
- 20 Kostot që nuk mund ti atribuohen aktivitetit të kontratës ose nuk mund ti përcaktohen një kontrate, përjashtohen nga kostot e një kontrate ndërtimi. Kosto të tilla përfshijnë:
- (a) kostot e përgjithshme administrative për të cilat nuk është përcaktuar ndonjë rimbursim në kontratë;
 - (b) kostot e shitjes;
 - (c) kostot kerkim zhvillimit për të cilat nuk është përcaktuar ndonjë rimbursim në kontratë; dhe
 - (d) amortizimi i paisjeve dhe makinerive inaktive që nuk janë përdorur në një kontratë të veçantë.
- 21 Kostot e kontratës përfshijnë kostot e atribuueshme në kontratë për periudhën nga data e negociimit të kontratës deri në përfundimin final të saj. Megjithatë, kostot që lidhen direkt me një kontratë dhe janë hasur në procesin e negociimit të kontratës përfshihen si pjesë të kostos së kontratës në qoftë se ato mund të identifikohen veçmas, të jenë të matshme si dhe ekziston mundësia që kontrata të nënshkruhet. Kur kostot që hasen në procesin e negociimit të kontratës njihen si shpenzime në atë periudhë kur ato janë kryer, ato nuk përfshihen në koston e kontratës kur kontrata nënshkruhet në një periudhë të mëvonshme.

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve të kontratës

- 22 **Kur rezultati i kontratave të ndërtimit mund të përcaktohet saktësisht, të ardhurat nga kontratat dhe kostot e lidhura me këto kontrata duhet të njihen si të ardhura dhe shpenzime respektivisht në fazën e realizimit të kontratës në ditën e mbylljes së bilancit. Një humbje e pritshme nga kontrata e ndërtimit duhet të njihet si humbje menjëherë në përputhje me paragrafin 36.**
- 23 **Në rastet kur çmimi i kontratës është i fiksuar, rezultati i kontratës së ndërtimit mund të parashikohet saktësisht kur permbushen të gjitha kushtet e mëposhtëme:**
- (a) Të ardhurat totale nga kontrata mund të maten në mënyrë të besueshme
 - (b) Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me këtë kontratë do të shkojnë subjektit;
 - (c) Kostot për përfundimin e kontratës si dhe faza e realizimit të kontratës mund të maten në mënyrë të besueshme në datën e bilancit; dhe
 - (d) kostot e kontratës që i përkasin kontratës mund të identifikohen lehtësisht dhe të parashikohen në mënyrë të saktë kështu që kostot aktuale mund të krahasohen me ato të parashikuara.
- 24 **Në rastet e kontratës me çmim plus, rezultati i kontratës së ndërtimit mund të matet në mënyrë të besueshme kur permbushen të gjitha kushtet e mëposhtëme:**
- (a) Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me këtë kontratë do të shkojnë subjektit; dhe
 - (b) kostot që i përkasin kontratës të rimbursueshme apo jo, mund të identifikohen dhe maten në mënyrë të besueshme.

- 25 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve duke ju referuar fazës së realizimit të kontratës njihet si metoda e përqindjes së realizimit. Me këtë metodë të ardhurat nga kontrata lidhen me kostot e kontratës të cilat janë kryer deri në fazën e realizimit, duke rezultuar në të ardhura të realizuara, shpenzime dhe fitim përkatës për pjesën e punës së kryer. Kjo metodë siguron informacion e nevojshem për vlerësimin e kontratës dhe të preformancës gjatë periudhës,
- 26 Me metodën e përqindjes së realizimit, të ardhurat njihen si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën kontabel në të cilën puna është kryer. Kostot e kontratës njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën kontabile në të cilën puna që ato i përkasin është kryer. Megjithatë çdo tejkallim i kostove të kontratës mbi të ardhurat e kontratës njihen menjëherë si shpenzime në përputhje me paragrafin 36.
- 27 Ndërtuesi mund të ketë kosto të kontratës që mund të lidhen me një ndodhi të kontratës në të ardhmen. Këto kosto të saj njihen si aktive duke patur parasysh që është e mundur që ato të rimerren. Këto kosto janë një shumë për t'u marrë prej klientit dhe klasifikohen si punime në process.
- 28 Rezultati i kontratave të ndërtimit mund të parashikohet saktësisht kur është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me këtë kontratë do të shkojnë subjektit. Megjithatë në rastet kur një pasiguri krijohet rreth arkëtimit të ndonjë shume që është përfshire në të ardhurat nga kontrata dhe është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve,, shuma e pa arkëtuar ose shuma për të cilën arkëtimi nuk është më i mundur njihet si shpenzim në vënd që të bëhet korigjimi i të ardhurave të kontratës.
- 29 Një subjekt në përgjithësi është i aftë për të bërë parashikime të sakta pasi ka arritur marrveshjen për kontratën ku saktëson si më poshte:
- (a) të drejtën e ligjshme të secilës palë mbi aktivin që do ndërtohet;
 - (b) pagesat që do të kryhen; dhe
 - (c) mënyrën dhe kushtet e pagesave.
- Është e nevojshme për subjektin të këtë një sistem buxhetimi dhe raportimi financiar të brëndëshëm i cili të jetë efektiv. Subjekti rishikon, dhe kur është e nevojshme, ndryshon parashikimet e të ardhurave dhe koston e kontratës ndërkohë që kontrata është në proces. Nevoja për këto ndryshime nuk nënkupton që rezultati i kontratës nuk mund të parashikohet saktësisht.
- 30 Faza e realizimit të kontratës mund të përcaktohet në disa menyra. Subjekti përdor metodën e cila mat me siguri punën e kryer. Në varësi të natyrës së kontratës metodat që mund të përdoren përfshijnë:
- (a) peshën që zë pjesa e koston së kontratës për punën e kryer e deri tani në koston totale të kontratës;
 - (b) inspektimin e punës së kryer; ose
 - (c) përfundimin e një pjese fizike të caktuar të punës së kontratës.
- Pagesat pjesore dhe avancat e marra nga klienti nuk reflektojnë punën e kryer.
- 31 Kur faza e realizimit përcaktohet nga kostoja e kontratës deri në një moment të caktuar, vetëm ato kosto që reflektojnë punën e kryer përfshihen në koston e kontratës, Ja disa shëmbuj të koston që nuk përfshihen:
- (a) kostot e kontratës që kanë lidhje me aktivitetin e ardhshëm të kontratës si psh kosto e materjaleve të dërguara në kantierin e kontratës ose të vëndosura mënjatë për tu përdorur në kontratë, por akoma të pavëna në përdroim, të përdorura gjatë zbatimit të kontratës, vetëm nëse materialet janë bërë posaçërisht për kontratën; dhe
 - (b) pagesa të bëra nënkontraktorëve në avancë për punë të kryera në nën-kontraktim.
- 32 **Kur rezultati i një kontrate ndërtimi nuk mund të vlerësohet ne menyre te besueshme**
- (a) **të ardhurat duhet të njihen deri në masën sa kostot kryera të kontratës konsiderohen të mundshme për tu arkëtuar; dhe**
 - (b) **kostot e kontratës duhet të njihen si shpenzim në periudhën që ka ndodhur shpenzimi.**
- Një humbje e pritshme nga kontrata e ndërtimit duhet të njihet si humbje menjëherë në përputhje me paragrafin 36.**

- 33 Gjatë fazave të para të zbatimit të kontratës zakonisht është vënë re që rezultati i kontratës nuk mund të vlerësohet me saktësi. Sidoqoftë ka mundësi që njesia ekonomike do të arkëtojë koston e kontratës. Kështu që të ardhurat nga kontrata njihen vetëm në atë masë që kostot e kontratës konsiderohen si të arkëtueshme. Meqenese rezultati i kontratës nuk mund të parashikohet me siguri atëherë nuk njihet fitim nga kontrata. Gjithësesi, dhe në rastet kur rezultati i kontratës nuk mund të parashikohet me siguri ka mundësi që kostot totale të kontratës do të tejkalojnë të ardhurat nga kontrata. Në të tilla raste çdo tejkallim i kostove mbi të ardhurat nga kontrata njihet si shpenzim menjëherë në përputhje me paragrafin 36.
- 34 Kostot e kontratës që ka mundësi të mos arkëtohen njihen menjëherë si shpenzim. Shëmbuj të rasteve kur arkëtimi i kostove të kontratës nuk është i mundshëm dhe që këto kosto do të njihen menjëherë si shpenzime përshijnë ato kontrata që:
- (a) nuk janë tërësisht të zbatueshme, psh vlefshmëria e tyre është seriozisht në pikepyetje;
 - (b) realizimi i të cilave varet nga rezultati i një çështje gjyqësore në proces ose nga legjislacioni;
 - (c) kanë lidhje me prona që janë subjekt i ndëshkimeve ligjore ose i sekuestrove;
 - (d) klienti nuk është në gjendje të përmbushi detyrimet e veta; ose
 - (e) kur kontraktori nuk është në gjendje të realizojë kontratën ose të përmbush detyrimet nën kontratë.
- 35 **Kur pasiguritë që pengojnë rezultatin e parashikuar të kontratës nuk ekzistojnë më, të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me kontratën duhet të njihen në përputhje me paragrafin 22 dhe jo me paragrafin 32.**

Njohja e humbjeve të parashikuara

- 36 **Kur është e mundshme që kosto totale e kontratës do jetë më e madhe se të ardhurat totale të kontratës humbja e pritshme duhet të regjistrohet si shpenzim menjëherë.**
- 37 Shuma e kësaj humbje është përcaktuar pavarësisht:
- (a) nëse puna ka filluar për këtë kontratë;
 - (b) nga faza e realizimit të kontratës; ose
 - (c) nga shuma e fitimit që pritet të përfitohet nga kontrata të tjera të cilat nuk janë trajtuar si kontrata ndërtimi individuale në përputhje me paragrafin 9.

Ndryshimi në parashikime

- 38 Metoda e përqindjes së realizimit aplikohet në baza akumulative në çdo periudhë kontabile mbi parashikimet aktuale të të ardhurave dhe kostove të projektit. Kështu që efekti i ndryshimit të vlerësimit të të ardhurave dhe kostove të kontratës ose ndryshimi i parashikimit të rezultatit të kontratës trajtohet si një ndryshim në vlerësimin kontabel. (shiko SNK 8 *Politikat Kontabile, Ndryshime në Vlerësimet Kontabile dhe Gabimet.*). Parashikimet e ndryshuara përdoren në përcaktimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në pasqyrën e fitim humbjeve në periudhën që ndryshimi u bë dhe në periudhat pasardhëse.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 39 **Një njesi ekonomike duhet të japë informacion të detajuar për :**
- (a) shumën e të ardhurave nga kontrata që është njohur si e ardhur gjatë periudhës;
 - (b) metodat e përdorura për të përcaktuar të ardhurat nga kontrata që janë njohur gjatë periudhës; dhe
 - (c) metodat e përdorura për të përcaktuar fazën e realizimit të kontratave në proces.

- 40 Një njesi ekonomike duhet të publikoje pikat e mëposhtme për cdo kontratë në proces në datën e mbylljes së bilancit:**
- (a) **shumën totale të kostove të realizuara dhe fitimet e njohura (minus humbjet e njohura);**
 - (b) **shumën e parapagimeve të marra; dhe**
 - (c) **shumën e fondeve të mbajtura nga klienti.**
- 41 Shumat e mbajtura janë shuma të faturave progressive që nuk paguhen deri në përmbushjen e kushteve të specifikuara në kontratë për pagesën e ketyre shumave ose deri kur defektet janë rregulluar. Faturimet progresive janë shuma të faturuara për punë të kryera në një kontratë të paguara ose jo nga klienti. Parapagimet janë shuma të marra nga ndërtuesi para kryerjes së punëve.
- 42 Një njesi ekonomike duhet të pasqyrojë:**
- (a) **shumën bruto të kërkesave për t'u arkëtuar nga klientet për punë të kontraktuar si një aktiv; dhe**
 - (b) **shumën bruto të detyrimeve ndaj klientëve për punë të kontraktuar si një detyrim në pasiv;**
- 43 Shuma bruto e kërkesave për arkëtim nga klientët për punë të kontraktuar është shuma neto e:
- (a) kostos së realizuar plus fitimet e njohura; minus
 - (b) shumës së humbjeve të njohura dhe faturimeve progresive
- për të gjitha kontratat në proces për të cilat kostot e kontratave plus fitimet e njohura (minus humbjet e njohura) tejkalojnë faturimet progresive.
- 44 Shuma bruto e detyrimeve ndaj klientëve për punë të kontraktuar është shuma neto e:
- (a) kostos së realizuar plus fitimet e njohura; minus
 - (b) shumës së humbjeve të njohura dhe faturimeve progresive
- për të gjitha kontratat në proces për të cilat faturimet progresive tejkalojnë kostot e kontratave plus fitimet e njohura (minus humbjet e njohura).
- 45 Një njesi ekonomike duhet të japë shpjegime për çdo detyrim të mundshëm ose për çdo kërkesë të mundshme në përputhje me SNK 37 *Provizione, Detyrime të Mundshme dhe Kërkesa të Mundshme*. Detyrime dhe kërkesa të mundshme mund të lindin nga shkaqe të tilla si Garanci, Pretendime, Gjoha ose humbje të mundshme.

Data efektive

- 46 Ky standard duhet aplikuar për pasqyrat financiare që mbulojnë për periudhat nga 1 Janar 1995 dhe mbas.**